


8SH-1

GJOKE BECI

B 35



KUR  
ZGJOHEN  
BJESHKET



891.983-1

1335

S

GJOKË BECI

KUR ZGJOHEN  
BJESHKËT

(Vargje)

~~50589~~

11549

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## MENDIME BUZË LUMIT DRIN

Na fliste për Drinin mësuesi flokëthinjur:  
— Kur rrëshqet mes alpesh si përbindësh i zgjidhur  
Uji i tij i errët nëpër shtrat të thellë  
Frikëson madje dhe kuçedrën në shpellë.  
Drini përmyt grunjërat, prish gurin e bën  
kokrrizë. . .  
E ç'nuk na thosh dikur, mësuesi i gjeografisë!

Mengadalë, o Drin! Mos e merr rrëmbyer!  
Fjalën nuk ta prenë shekujt, as malet,  
Por këta punëtorë që shkëmbin kanë zbrërthyer  
Po e mësojnë vrullin tënd të ndalet.

Vërtet Drin, ti di më shumë se ne. . .  
Pa na trego me pëshpëritjen e valëve  
Si i mbajte mbi vete lugjeve, atje,  
Rrëketë e gjata të dhimbjes së maleve?

Brëketë që vareshin teposhtë nga kodrinat,  
Ç'të thoshin kur derdheshin përmes shkulmit tënd;  
Nervoz, kur thyeje mbi valë vetëtimat,  
Drita elektrike mos vallë të shkoi ndërmend?

Brigjeve të Drinit, kur vjeshta ze afrohet  
Pemët lidhin kokrra dhe rëndojnë degët...  
Ai shkund ëndërrimet e dridhshëm zgjohet  
Duke kërkuar brigjeve të bukura delet.  
Që larg sheh të bardhat shtëpitë e puntorëve,  
Shtylla elektriku që lidhin kokrra të zjarrita;  
Pastaj ndjek rrugës kollonën e izolatorëve,  
Takon fshatarë të ngarkuar me radio e llamba!  
Po, Drin! Kjo është stina e madhe e dritave,  
Këtë stinë ja shtoi Shqipërisë Partia!  
Kjo stinë është si ajo e luleve, e drithrave  
Hambaret e gëzimit në të po i mbush malësia.

Mjaft pat krisë pushka n'atë breg Drini...  
S'ka më ujë për rrëketë e elegjive!  
Kjo bateri minash dhe maloren peshë e dridhi,  
Shih si zgjaten maleve fitilat e energjive!  
Kanë vënë veshin kreshtat e dëgjojnë.  
Kanë shtuar ujin gurrat e vërshojnë.

\* \* \*

Krisën minat mbrëmë. Jehona mbeti.  
Hej, ç'na shuan mallin e betejës  
Ne që erdhem dje nga Kryeqyteti  
Vullnetarë këtu, në Vaun e Dejës.

Ne që morëm rrugëve përshëndetje  
Dhe me dritën ramë në dashuri,  
S'na shqetësojnë lulishteve pikëpjekje,  
As blerja e një kostumi të ri.

Këtu ne gjetëm vrullin që nuk ndalet  
Dhe u shkrimë me të për të marshuar.  
Pra mblidhu Drin, a po i dëgjon malet  
Si zgjatin këngën e dritës së pashuar!?

Kanë venë veshin kreshtat e dëgjojnë.  
Kanë shtuar ujin gurrat e vërshojnë.

Rrëketë që vareshin teposhtë nga kodrinat,  
Ç'të thoshin kur derdheshin përmes shkullmit tënd;  
Nervoz, kur thyeje mbi valë vetëtimat,  
Drita elektrike mos vallë të shkoi ndërmend?

Brigjeve të Drinit, kur vjeshta ze afrohet  
Pemët lidhin kokrra dhe rëndojnë degët...  
Ai shkund ëndërrimet e dridhshëm zgjohet  
Duke kërkuar brigjeve të bukura delet.  
Që larg sheh të bardhat shtëpitë e puntorëve,  
Shtylla elektriku që lidhin kokrra të zjarrita;  
Pastaj ndjek rrugës kollonën e izolatorëve,  
Takon fshatarë të ngarkuar me radio e llamba!  
Po, Drin! Kjo është stina e madhe e dritave,  
Këtë stinë ja shtoi Shqipërisë Partia!  
Kjo stinë është si ajo e luleve, e drithrave  
Hambaret e gëzimit në të po i mbush malësia.

Mjaft pat krisë pushka n'atë breg Drini...  
S'ka më ujë për rrëketë e elegjive!  
Kjo bateri minash dhe maloren peshë e dridhi,  
Shih si zgjaten maleve fitilat e energjive!  
Kanë vënë veshin kreshtat e dëgjojnë.  
Kanë shtuar ujin gurrat e vërshojnë.

\* \* \*

Krisën minat mbrëmë. Jehona mbeti.  
Hej, ç'na shuan mallin e betejës  
Ne që erdhem dje nga Kryeqyteti  
Vullnetarë këtu, në Vaun e Dejës.

Ne që morëm rrugëve përshëndetje  
Dhe me dritën ramë në dashuri,  
S'na shqetësojnë lulishteve pikëpjekje,  
As blerja e një kostumi të ri.

Këtu ne gjetëm vrullin që nuk ndalet  
Dhe u shkrimë me të për të marshuar.  
Pra mblidhu Drin, a po i dëgjon malet  
Si zgjatin këngën e dritës së pashuar!?

Kanë venë veshin kreshtat e dëgjojnë.  
Kanë shtuar ujin gurrat e vërshojnë.



## DJE TE LAPIDARI

Erdha dje me rininë te lapidari,  
Ishin mbledhur shumë njerëz  
Shumë këngë, shumë dashuri,  
Mes tyre kishte vajza me uniformë ushtari  
Ashtu siç kishte vajza me shami.

— Këtu na ra një shok — tregon oficeri;  
Ishte i ri, si ti djalosh, kështu i gjatë.  
Ishte zemërmënë. Kishte forcë artiljeri,  
Luftoi me gjermanët heroikisht — një me gjashtë.

Ai kish veç një nënë, e donte nënën shumë;  
Na fliste për të shpesh ditëve dhe netëve  
Dhe kur flinim duke ecur në rrugë e nëpër lumë,  
Dhe kur pastronim armët pas ndonjë përpjekjeje.

Atë ditë ai ra mbi të dashurin top të tij,  
U shkri me të, u bë pjesë e pandarë çeliku

Dhe ja, atje poshtë tani çlodhet ai  
Si rapsodi e heshtur në një gjoks kreshniku...

\* \* \*

Erdha dje me rininë te lapidari,  
Ishin mbledhur shumë njerëz, shumë këngë  
Nën qiellin blu.  
Mes lisash, mes kodrash ku tokën bleron bari  
Na u duk se tha dikush: — Jam dhe unë këtu!

## TREGIMI I VETERANIT

Një muaj sëbashku. Erdhi dita e përcjelljes.  
Ka më pak fletë se njerëz te ky mriz.  
Durrshake e mirditore ja nisin mbledhjes:  
Veterani këngën ndal, e fjalën nis. . .

— S'jemi miq, por jemi vëllezër shqiptarë,  
Këtë emër në çdo zemër ruajtëm thellë,  
Porse shekujt nëpër rrokje e patën ndarë  
Hasmërinë përmes tyre duke mbjellë.

Veçse rrokjet nga rrebeshet nuk u ndanë;  
Me gjak shokësh i salduam atë Nëndor,  
E bëmë bombë këtë emër për tiranët,  
E bëmë flamur mbi Korab e mbi Tomorr!

S'patëm kohë për t'u çmallur kështu grup  
Për t'u rrokur me kaq zjarr e dashuri,

Se atdheu kishte plagë nëpër trup.  
Se dhe rrugët të qenë mpirë, Shqipëri!

Ja pse malli është i fortë. Bjere dorën!  
Ndaj atdheu është i shtrenjtë. Merre besën!  
Me këto duar dimë ta mbrojmë ne fitoren.  
Për partinë kështu së toku dimë të vdesim!

## KIRURGËT E MALEVE

— *Shokëve të mi gjeologë* —

Rreth maleve  
Nata duket sikur rrënoqethet.  
Dhe lisi me lëkurën më të regjur,  
Nga të ftohtët dridhet...  
Bjeshka mbështjell kodrave  
Bardhësinë që bora e përjetme ka shpalosur.

Ata nga bujtina dhe gjiri i shokëve  
Dalin shpejt:  
Shokët s'duhën zgjuar.  
Përmes ëndërave të tyre,  
Një mëngjez të kthjellët,  
Nesër do të sjellë  
Ky turn i tretë  
I gëzuar.

Me mushama dhe fjolla bore veshur  
Ecin.

Pas zërit të sondës  
Rrugën duke ndjekur,  
Ecin.

Ata e dinë:

Një natë të errët  
Dhe më të gjatë se ajo e së kaluarës  
Do shpojnë tej për tej  
Koronkat e sondave.

... Vështrojnë kampionët. Përqafohen.  
— Ti tokë ke nevojë të operohesh:  
Plagët janë të lashta, shekullore.  
Shumë terr derdhën kohrat mbi ne,  
Që të mos guxonin malësorë e malësore  
Plagët e tokës,  
Mrryljen e tokës,  
Ankthin e tokës, floririn e tokës  
Ta vështronin drejt në sy!

Kohrat deshën të na rrëzonin, tokë e dashur,  
Po rrënjët ti na i ushqeve me trimëri.

Ndaj ne i mundëm të gjitha: *Ne çështim e m*

Dhimbjet

urinë

terrin

Duke t'i operuar plagët e rënda ty.  
Tani ti tokë ndjen mbi supet e maleve  
Shqetësimin dhe këngët e kërkuesve të mineraleve.

Ata, si kirurgu të sëmurin  
Pastrojnë nga «mish' i huaj»  
Të kuqin,  
Të shëndritshmin,  
Të nevojshmin,  
Gurin.

Atë gur, o tokë, e mbajte thellë në gji  
Askujt s'ja tregove,  
Askujt s'ja dhe;  
Dhe askujt s'do t'i duket nesër çudi,  
Që ne na e dhurove,

Vetëm ne,  
Se ne në vazhdim të krismave partizane  
(Nga të cilat lindën krismat e çekanëve)  
Krisma të reja lëshojmë mbi male.

Kështu, nga të gjithë brezat që shkuan  
Plagët e shekujve, ne  
Përjetësisht t'i shëruam.

Do të ndjesh, o tokë përsëri, në krahuar  
Gjëmimin e minave dhe këngëve  
Dhe do të dridhesh nën gurët e çmuar  
Duke ndjerë më pranë  
Rrahjet e zemrave.

Janë më të rëndë ata gurë se pesha e fjalëve,  
Ndaj, sonte s'kanë të ftohët aspak,  
Kërkojnë shumë e flasin pak  
Kirurgët e maleve.



## GJIROKASTËR

Dhjetë vjet piva ujë, thitha ajër të pastër  
Rrugëve të tua të pjerrta, të gurta,  
Ku bisedat e njerëzve të tu, Gjirokastër,  
I dëgjova si fjalët e urta.

Sopotit mëngjezeve te zbret kaltërsia,  
Ashtu si partizanët kur sollën lirinë;  
Mua në shpirt e ngrohët më hyri poezia  
Si dhe kënga për Muzo Asqerinë.

Si rrjedhja e ujrave të kaltra pranverore  
Nga lagjet e tua zbresin njerëz të fortë  
Dhe shkrihen në lumin e ditëve punëtore,  
Në lumin më të vrullshëm në botë.

Në «Qafën e Pazarit» (ky emër duhet hequr)  
Nuk ka më pazar thashethemesh,

Gabimet e shekujve rrugëve duke ndrequr  
Pashë duarartët punëtorë të kalldrëmeve.

Pastaj duke ecur mbi gurët e latuar  
Ndonjë motiv më ka lindur patjetër  
Për dy të rinj të sapo dashuruar  
Apo për kalanë e murrme, të vjetër.

Me shokët e mi letrarë shpesh rrugës  
U frymëzova nga njerëz, fusha, male...  
Por nga Palortoja, nga muzeu i luftës  
Më buron dashuria dhe kënga më e madhe.

## KUR ZGJOHEN BJESHKËT

Kur zgjohen bjeshkët, hedhin sytë nga fushat,  
Afish i mëngjezit ndez dëshirën për punë;  
Shamitë e aksionit zbukurojnë gushat.  
Siç zbukuron kodrat, pranverës, një lumë.

Shamitë e aksionit dhe pantallonat gri  
Mbetën në trupin e cucave malësore  
Një kujtim i bukur — peisazh i ri  
Mbi shkrepat dhe shamitë e zeza shekullore.

Me flokë të lirë shpupuritur në fllad  
Të parat rendin këto cuca përsëri  
Aty ku hapet rrugë e re në fshat,  
Duke thyer shkëmbej dhe koncepte me qysqi.

## TINGUJ TË VENDIT TIM

Ulem këmbëkryq në një cep të prehrit tënd,  
O vendi im  
Dhe dëgjoj tingujt e një kënge të lashtë.

Një tingull më vjen nga koha e Skënderbeut  
(Sapo doli nga teh i shpatës në muze.)  
Një tjetër nga ballkon i Vlorës së Ismailit,  
Ku gjysma e hënës ra copë-copë përdhé.

Shqipëri,  
Hej, sa trimëri ti mbolle  
Në fushën e madhe — Histori,  
Dhe u ujite me gjakun, që nëpër kohra derdhe.

Po turqit? ç'deshën turqit që të vinin  
(Dy herë në vit)  
Në të mbjella dhe në të korra?...

Ç'libër të bukur fshihje në këto brigje  
 Që erdhën ta lexonin akademistë nga Europa,  
 Apo historinë tënde me të rreptat ligje,  
 Më t'ashpra për ta se këto male me sopa!

Shekujt i bëre shportë me plumba dhe krisma!  
 Shekulli i Njështë gjëmime të reja ndizte,  
 Kur do të lindte dielli mbi heroizma  
 Lindi në Tiranë Partia Komuniste.

O brezi im që pushkën herët dot s'e kape  
 Kur lindi partia, ti ishe i mitur;  
 Ne deshëm të mbushnim qiellin me ballona  
 Në njëmijë ngjyra spektrash të ndritur.

Po ballonat tona s'i lanë të ngriheshin  
 Avionet armiq,  
                                     që me malet grindeshin  
 U deshën pushkët partizane të ushtonin  
 Që qiellin e nxirë ta pastronin.

Më shumë se një çerek shekulli  
 (Ngjyrosur me rrezet e diellit të Nëndorit)  
 Tesera jote, Parti  
 Rriti në fletën e parë  
 Emërin Shqipëri.

I thjeshtë ky emri yt, Parti  
Por tingull i dashur, si zëri i së vërtetës,  
Në megafonët e revolucioneve proletare.

Atdhe  
Rritet kënga jote,  
Tinguj të rinj përditë më rritin mua.

Unë dua të jem një notë  
Diku,  
Në këngët e tua,  
Në tingujt e tu.

## BALLADË PËR SHKURTE CARËN

Rrinin majat si motiv i trishtuar  
Mbi fshatin tonë rreth kullave të larta;  
Trishtimi i tyre në shpirt na brofi  
Kur zbriti nata  
Kur nxiu nata!

Nga mbledhja ti dole tepër e gëzuar.  
Komunistët trishtimin pas dore e linin!  
Nxitoje. Në shtëpi feneri të priste i pushuar,  
Që të lexoje sërishmi Leninin.

Nga era e mendimeve të tua optimiste  
Fërgëllonin fletët nën dritën e fenerit;  
Ndërsa në mur buzëqeshur të priste  
Portreti i shtrenjtë i Enverit.

Rrugëve të ngushta në pyllin e ngjeshur  
Nxitoje mbi kalin e bardhë të gëzimit,  
Se rrugëve të ngushta, o Shkurtë, kishe gjetur  
Rrugën e gjërë të qëllimit.

Mes dritës së hënës gjykoje për... dasmat,  
Për honet e zeza, për lulet, për basmat,  
Për shoqet e tua duar-arta.

Tek po ëndërroje kërcitjen e minave  
Dhe varg pas tyre vagona minerali  
Dëgjove ca zëra të mekur si të minjve...  
... Një krismë që ëndërat t'i ndali.

Nuk i pe lisat sesi ulën kokën  
Dhe të pyetën se ç'po shihje ëndër.  
Kishe përçafuar fort Ti, tokën,  
Ishe shkrirë në fjalën më të ëmbël...

Si mund të t'zgjonte klithm' e kriminelit?  
Flladi i bjeshkës mbi supe të kish zbritur!  
Kishe ngjeshur brez me yje belit,  
Kishe vënë mbi ballë hënën e ndritur.

O motër, u ngrit Mirditës trimëreshë  
Zemrimi ynë — vullkan mbi kriminelët...  
Ti, Shkurtë, ëndërron mes njerëzish  
në Kurbnesh  
Me një brez me yje ngjeshur belit.



## KUR SHKOJ NË TELEGRAFË

Tingujt e telegrafës i dua sa dhe të muzikës  
Ti shok muzikant mos më vështro shtrembër!  
Dikush dashuron poetikën e uzinës:  
Por unë jam telegrafist — më pëlqen ky emër!

Dhe kur shkoj në telegrafë, ditën apo natën  
Zërin e atdheut nëpër tela ngado ndjej  
Dhe e njoh si zërin e dashur të nënës!  
Kilometrat e tij me këta tre gishta nuk maten  
Për dy gjëra janë këta gishta:  
Për ritme dhe këmbëz!

## MBI URËN E FANIT

Që unë kam qëndruar mbi urën e Fanit  
Kjo, sigurisht, askujt s'i hyn në punë,  
Nëqoftëse nuk flas për uzinën e metalit,  
Nëqoftëse s'bisedoj me oxhaqet gjuhë shtëllungë.

Malet përreth vazhdojnë të mendojnë,  
Me fshesë të gjelbër u fshiu thinjat pranvera.  
Puntorët në uzinë shkallë të reja montojnë,  
Rritu shpejt — po i thotë uzinës miniera.

Dhe rritet kështu një furrë e re, mbi tokë,  
E zjarrtë dhe e madhe sa zemra e kolektivit,  
Prej saj rrjedh si llavë, ajka e bakrit, shokë  
Dhe shkrihet aty ndryshku i individit.

Artereve të uzinës rrjedh bakër i kuq.  
Forca e atdheut shpërthen dritë nër tela.  
Nga dheu i taracave Fani vjen i kuq,  
Ndërsa lart ngjiten minatorët me martela.

## BISEDË ME VAJZËN

Përse, o vajzë, dorën e frikësuar  
Në gishtat e mi e lëshove tërë heshtje,  
Si një mendim të gabuar,  
Që kërkon ta tërheqësh?

Unë jam elektrikist,  
Montoj llamba nër male,  
Atje ku uria dikur hahej në vend të bukës;  
Atje ku kanuni përhapte dhimbje të madhe  
Sa dhe plagët e luftës.

Ndaj, o vajzë, këta gishta sdijnë naze;  
M'i ashpëruan telat vezullues;  
Për ta është i vogël rreth i një unaze,  
Siç ish e vogël martesë me shkues.

A ka unazë më të bukur se kjo  
Që ne po u lidhim maleve ndër gishta,  
Se dhe dashurinë tonë e çliron ajo  
Duke përvëlur frikë, kanune, krishta.

## PËR MIGJENIN

O njerëz që montoni llampa në bjeshkë  
Sikur montoni zikzake rrufeshë,  
Ndaluni pak, kjo s'është gjë e thjeshtë,  
Janë motivet e dritës,  
Që Milloshin ngritën peshë.

Në dëgjofshi ju, gjëmime të largëta  
Jo, mos u ndalni, shpejtojeni montimin:  
Është kënga e tij, ngjitet majave të larta  
Për të përshëndetur  
Elektrifikimin!

## DUVAKU I GRISUR

Duke grisur duvakun faqe gjithë katundit  
Gjystja u çeli cucave derën e guximit;  
Atë e patën mbyllur nenet e kanunit,  
Siç mbyllin ferrat një udhë të harruar,  
Siç mbyllin kuçedrat rrjedhën e burimit  
Në një legjendë të lashtë, të trishtuar.

## DËSHIRË

Në netët e qeta,  
Në ditët kur kopetë ngjiten në veri  
E rinia zbret në trase,  
Ditëve që lindin mbi vrull e poterë,  
Trokasin në portat e tua, atdhe,  
Me qindra e qindra postjerë.

Që të trokas në zemrat e njerëzisë,  
Do doja të jem  
postjer i poezisë.

## NJERIU I BRONXTË

Kur zbresin nga bjeshkët malësorë e malësore  
Me zemër kuvëdojnë me bustin buzë udhës,  
Atë e përshëndesin sot cucat mirditore,  
Që me këngë dhe vrull po i shkojnë hekurudhës.

Flamurët fërfërijnë mëngjezeve me diell,  
Nga busti, i bronxtë buzëqesh Bardhok Biba;  
Farën e këtyre ditëve, me partinë këtu pat mbjellë  
Ndaj në bronx dhe në këngë e derdhi atë Mirdita.

## NJË DRITË E FORTË

(Për Pjetër Lleshin)

Kur zemrim' i natyrës me ndërgjegjen tënde  
ndeshi

Shpërtheu atbotë një shkëndi e fortë!  
Na mbete vetëtimë në muzg të atij rrebeshi  
Në ndërgjegjen tonë —  
Një dritë e fortë!

... Dhe pati nën linjat e tua, o Pjetër Lleshi  
Shkëmbinj të bardhë, të latuar,  
Hone të thellë dhe ujqër të tërbuar.

Majë shkëmbinjve të lidhje lajmërimet,  
Kurse honeve gremisje paragjykimet!



Furtuna të hodhi tërbimin supeve  
Ty, kundërshtarit  
Të këputjeve,

rehatllëkut

dhe acarit;

Po ti vazhdove rrugën tënde nën tela  
Duke ndërlidhur brohoritjen e fshatarësisë.  
Dëgjuan malet dhe honet e thella.  
Kolektivizimin e bujqësisë!

Veç ti nuk munde të dëgjosh  
Këngët që këndojmë për ty,  
Ato ushtojnë Shqipërisë qosh më qosh  
Kudo ku lidhim linja përsëri.

## LETËR STUDENTES

Ne jemi një grup të rinjsh nga katundi.  
Sapo u kthjem nga tokat e reja;  
Kur kujtojmë djersën që shterpsin' e tokës mundi,  
Na duket se kthehemi fitimtarë nga beteja.

Nga bjeshkët në katund sonte gëzimi ka zbritur,  
Hej, shoqja jonë, po çmendet çiftelia!  
Edhe ajo e di: Ti drejt nesh je nisur,  
Pra shpejt, agronome të pret ty malësia!

Atje në fakultet shumë shoqe do të kesh zënë...  
Fshati sonte s'fjeti. Lindja flakë u ndez.  
Merri dhe buzëqeshjet tona, o shoqe, për tu thënë  
Të gjithë studentëve, më fuqishëm:  
Mirmëngjez!

## PYETJE POEZISË

Poezi, o e gjelbëra ndjenjë,  
Në gjoks këtij malësori  
I dhe rrahjet e para  
Kur midis flokëve gështenjë  
I kanë mbirë dhe thinja të bardha...

— Luftuam burokratët që, me kokë në letra  
Harruan fare se këmbët i kanë në tokë!  
Heu, sa fishekë na u deshën për zakonet e vjetra!  
Dhe kështu, siç e shihni: — u thinjëm, shokë!

Në rrugën tonë mbajtëm ca shënime:  
Vargjet e para qenkan si hapat e para!  
Na thuaj poezi, që na ndez me frymëzime:  
A prishin punë thinjat e bardha? —

. . . Ky malësor u thinj pa ndjerë keqardhje,  
Se këngët i zjejnë vullkan në kraharuar;  
Vargjet janë të kuq, nuk durojnë zbardhje  
Si flokët e tij mbi ballin e vijëzuar.

## NGA DITARI I VITIT 1967

### 1) Partia

Partia ime është forca e zemrës shqiptare  
E grumbulluar në shekuj trimërisht;  
Është ndërgjegjja jonë revolucionare  
Gatuar me vetëtima të zjarrita stuhish.

### 2) Rend kënga

Të shkruaj për ty Shkurtë, më tha nëna,  
Më thanë vëllezërit, motrat mirditore,  
Më tha gjyshi i dëshmorit — Prenga,  
Më thanë malet, gurrat argjendore.

Të gjithë të njohin anembanë, motër.  
Të gjithë të duam siç duam partinë;

Vërtet ti linde në një fshat të Shkodrës  
Po vëllezër e motra ke në gjithë Shqipërinë.

Gjyshja Vitë këndon në Myzeqe  
Tek përkund të shtrenjtën mbesë te vatra  
Një ninullë të bukur dhe të re:  
— Të më rritesh yll si Shkurte Vata!

Vajza rritet. Kënga rend te vullnetarët,  
Flladi që shpalos flamujt e shpërndan  
Në Pecaj

Tragjas

Vërzhezhë

Maqellarë...

Atdheu këtë këngë në buzë e mban.

### 3) Një urim i ri

Nga të panjohurit e mi  
Më i dashuri,  
Nga të panjohurit e mi  
Më i afërmi,  
Emrin tënd mes heronjve të kohës e gjeta,  
O Fuat, trim pa sy,  
Tungjatjeta!

Sa shpejt ta mësuan emrin shqiptarët mbarë,  
Të nesërmen na u duk se njiheshim dhe më parë  
(Siç njohin shokët e turnit të natës  
Sulmuesin më të mirë të brigadës.)

Na thanë se dritën që të shkrepse si nur  
Ta rrëmbeu një bombë gjermane dikur.  
Po të kish mbetur gjallë gjerman i egër  
Do të ngërdheshej kur të shihte sytë e gjelbër. . .

Po ti e munde histerinë e armikut dhe errësirën,  
Me sytë e partisë ti sheh gjithë hapsirën,  
Sheh bimët e arës, ndjen tingullin e shatës,  
Ti ngrihesh e shtyn para karron e Shkurte Vatës!

. . . E nisi mirditorja cucën në hekurudhë;  
Një urim dëgjohet në të dalë të fshatit:  
— Të na dalë pesë herë sulmuese, he burrë!  
Për atdheun vetmohuese të jetë, si Fuati.

#### 4) Forca e partisë

« . . . Shihni se ç'bën forca e madhe e partisë. . . ! »

ENVER

Kur shqetësohet deti,  
Kur tërbon tërmeti,

Kur lëkundet dheu,  
Kur thërret atdheu  
Bijtë e Shqipërisë kush i çon në këmbë?  
— Zëri i partisë — Madhështorja këngë!

Një tërmet i egër  
Theu dru e tjegull,  
Na rrafshoi shtëpitë,  
Ku t'i çojmë fëmijtë?  
Vëllezërit për vëllezërit kush i çoi në këmbë?  
— Zëri i partisë — Madhështorja këngë!

Rendin muratorët,  
Labërit, Zadrinorët,  
Teknikë, shoferë,  
Dimërin e bëjnë verë!  
Shtëpitë e rrafshuara kush i çoi në këmbë?  
Forca e partisë — Madhështorja këngë!

### 5) Vrapon drita

U shkrinë poetët dëshires së madhe  
Atdheut t'i bëheshin pak dritë.  
Dhe zemrat e tyre i lanë mbi male  
Si armë të pazbrazura tek frëngjitë  
Kjo ëndër e lashtë dhe dëshirë e largët  
Qe shkruar në Traktin e parë të Partisë;  
Sot në linja tensioni të lartë  
Vrapon e ndezur  
Shqipërinë ta shëndrisë!



## FORCË NGA MALET

— *Për njerëzit me uniformë* —

Ju njohim, o njerëz me uniformë,  
Mbi shkëmbin e rreptë  
Nën gjethin e njomë,  
Me pushkën partizane në sup tek marshoni,  
Me pushkën e trimave në sup  
Ju vigjiloni!

Ju shohim, o njerëz me uniformë,  
Kur taracave derdheni si bujq me diplomë;  
Kur djersën ia falni lodhjes që s'e përfillni  
Maleve, ku forcë ju merrni dhe mbillni!  
Poligoneve, piramidave  
Dhe ne jemi me ju

Netëve të ftohta  
Dhe mëngjezeve blu.

E mbani ju veshur uniformën e ushtarit  
Për të mbajtur ngrohët lirinë e shqiptarit.

## KUR LIND DIELLI

Me flakë të kuqe errësirën përcëllon,  
Ngjitet e vështron në çdo majë epike;  
Më duket ky lëmsh i zjarrtë kur agon  
Si syri i ndezur i pushkës komite.

Kështu, pushkët shkrepnin tek ne mbi shpate  
Të përcëllonin natën dhe robërinë,  
Bashkoheshin me to të tjera ndaj nate,  
Si duartrokitje të forta për lirinë.

## MEDALJA E POETIT

Këndoi thëllëzën dhe petalet,  
Këndoi burimin dhe barinë,  
Në gjoks ai mbajti si medalje  
Emrin Shqiptar  
Edhe Lirinë.

I tillë u end mes klimës së Anadollit  
Përmes stuhisë së mallit për atdhenë,  
Kur pinte tok me kafën e Stambollit  
Urrejtjen e hidhur  
Urrejtjen e thellë.

Ndaj nga buzët e stuhishme  
Rrodhën vargjet atëherë  
Si një rreze e fortë, e ndritshme:  
... «Kujto vendin tek ke lerë...».

## PËR VARRET E HUAJ

Të rënda këto varre që shpuan këtë tokë,  
E fortë kjo tokë që mbajti këto varre.  
Kur pushka shfrynte urrejtjen e fortë  
Armiqtë të mundur u fshehën në varre.

Kjo tokë s'duronte t'ju mbante në gji,  
— Ëndërronjës statujash me kryet në ré —  
Ndaj ju ktheu në varre pa nam e lavdi,  
Mbuluar nxituar me tri kazma dhé.

Dikush për ju mund të mbajë medalje  
Dhe t'ju përshpirtë me kryq e pëllumba,  
Por plumb të rënda ç'ju peshojnë këto male,  
Që ju guxuat t'i goditni me plumba...

... Dhe sot kudo ku jini e s'jini,  
Mos i harroni, armiq, këto varre,  
Ulni ballin, të mundur, e rrini:  
Marshon Shqipëria

Njëzetepesëvjeçare!

## MOTIVE MIRDITORE

\* \* \*

E ndrojtur, si lypse e dikurshme mirditore  
Kjo udhë e vjetër nxjerr kryet në tërthore  
Që falje t'u kërkojë përditë udhëtarëve  
Për opingat që u grisi ndër shekuj baballarëve.

Rrugë të ngushta që kalbeni nën gjethe,  
(Që lëkunden të verdha si duar me ethe)  
Kryet e ndrojtur buzë xhadeve nxirrni  
Ëndërrimet padashur si shtiza m'i therni:

Me ju, o rrugë të ngushtëza fare  
Mirdita ndër lidhej me botën e madhe!

O Mirditë nënoke! Këtyre rrugëve të ngushta  
Sa herë shtrënguam opingat lekurë lope  
Mëngjezeve të hirtë, mbrëmjeve të vona  
Kur vërtiteshim rreth globit të halleve tona  
Në diell dhe shtrëngatë.

Në supe mbajtëm atë pushkën e gjatë  
Që kurrë s'e lëshuam as ditë, as natë.

Rrugëve të tua si artere anemiku  
Kaluan taksmbledhës me çanta dhe thikë,  
Por kurrë s'u ngjit në rrugët e tërthorta  
Një copë linjë elektriku,  
Një radio, një harmonikë.

T'i shkelën shtigjet qindra xhandarë  
Po kurrë më tepër se tre arsimitarë;  
Ku ta dije ti ç'ishin pedagogët?  
Ashtu si s'ti njihnin rrugët e tua mjekët  
Ndër shekuj s't'i gjetën as gjeologët.

Luteshe dhe futeshe në vakëfe, altare  
Mirdita ime e varfër dhe bujare,  
Përherë e panginjur me bukë e lakër,  
Megjithëse gjoksin e kishe plot bakër.

Ndoshta kishe parë fshehur dy dashnorë  
Po kurrë një çift në valle dorë për dorë.

Ti shpesh kishe parë të vriteshin dy vëllezër,  
Se njëri i preu tjetrit një dardhë të egër;  
Në vendin ku dardha gjeth më s'lëshonte  
Brez pas brezi hasmëria lulëzonte. . .

\* \* \*

Si gjarpërinj të ftohtë pas shkurresh,  
Pranë pushkësh, mbështetur pas gurësh  
Pusitë mes ankthit përgjonin parreshtur  
Të gatshëm  
Të heshtur.

Ja! Rrugën e ngushtë me gjoksin e gjerë  
Po çan ai, që pritej me orë. . .  
Pritej  
Të vritej.  
Tytat lëviznin si trarë të një postbloku  
Të shkretë;  
Uleshin, fiksoheshin për të ndaluar  
Një jetë.  
(Sa zemra ndaluan rrahjen befas  
Në postbloqet e tu ilegalë  
Që kohrat të vunë në pragjet e jetës,  
O Mirditë e pavdekshme mbi male?!).



Si mund ta harrojmë mësuesin e parë  
Me pallto shajaku, me kësulë të bardhë?  
Në çantë ai kishte libra dhe revole. . .  
Në sytë e ëmbël — shkëndia revolte.  
Dhe rrinin librat me revolen aq pranë  
Si kurrë në jetë kështu s'kishin qënë.

Në mësim na i shpjegonte të dyja  
Dhe librin dhe armën e shtrenjtë;  
Ne shpejt  
Krenaria  
Na çonte gjer në ré,  
Ndonëse rrinim këmbëkryq mbi dhé.

O, sa pak gjëra dinim ne atëherë!  
Kur mësuesin na e vranë në mes të klasës  
Mësuam sa i rreptë është zemrimi i masës.

Dhe rrypat e çantave mbi supet e njoma  
U bënë rrypat e armëve tona.

\* \* \*

Tri dalta te mprehta në shkëmb matin forcat,  
Tri karro, të lehta lëviznin mbi shina;  
Kjo tokë e thinjur të forta i ka kockat  
Ndaj duheshin mina, shumë mina. . .

Qe fillim!

Të nesërmen barangat do të shtoheshin.

Qe fillim! Të nesërmen të rënda karrot do lëviznin.

Qe fillim! Me këngët e minave malet do të  
zgjoheshin.

Qe fillim! Të derdhur në bakër të kuq

Do të shëndrisnin

Statujat e Heronjve të Lirisë,

Portretet e Heronjve të Punës Socialiste.

\* \* \*

Loste një fëmi me një hekur pushke  
Brigjeve të Matit mbi shalë të një mushke  
Dhe ëndërronte Mati qerpik shelg  
E murmuriste gurgullt Mati vetull shkëmb:  
«Ç'desh në shtratin tim kjo tytë kalibër — belg,  
Sa herë nga klithm' e saj gjaku blu m'u tremb?  
. . . Kërkëllinin dëndur korbat nëpër shpate,  
Pas çdo krisme korba vinin rrotull.  
Sa kalibra armësh u mundën nga spatat,

Sa ngjyra tankesh i ndryshkën rrotat  
Pranë brigjeve të mi  
Kur gjaku blu m'u tremb? . . .»  
Dhe aty ku kalibrat u mundën nga spatat  
Lindën dritat, që shtigjet tona ndrisin,  
Ndërsa barkat mes liqenit ndejnë si lopatat  
Shtyjnë këngët që peshkatarët lehtë nisin.  
Se erdhi një mëngjez rinia e atdheut  
Një digë t'u vuri kujtimeve të vrazhda.  
Romantika jonë, o Mat të rrëmbeu  
Ndaj u derdhe për ne nër tela dhe të lashta.

\* \* \*

Si udhëtar i përjetshëm Fani ecën poshtë  
Këngët e valëve duke mbjellur brigjeve.  
Kjo këngë është e lashtë  
Kjo këngë është pa nota,  
Tingujt e saj herë-herë janë lirikë  
Herë-herë të vrullshëm, të fortë.

Fani ecën poshtë, unë lart po ngjitem,  
Ngjitem shtigjeve të reja të Mirditës,  
Ku kaluan partizanët dhe lanë në këngën e madhe  
tinguj!

Xhaferr Lubonja e Pano Xhamballo mes tingujve  
ngrihen;

Drejt heroizmit të tyre ngjitem si drejt dritës.

Që nga lapidari më përshëndet me dorë

Hajdar Tafë Goriçani,

Më thërret atje majë bjeshkësh me borë

Të më tregojë si mundet tufani.

Unë ngjitem buzë Fanit.

Teposhtë zbresin cuca për në hekurudhë dhe  
shkolla.

Andej këndeje gërshetohen rrugë iniciativash. . .

## KATËR HEROINAVE TË MIRDITËS

Po harruan armiqtë se s'mund të mateshin me diellin,  
Harruan se s'mund të ndalnin shpërthimin e luleve  
Që popujt me gjakun e tyre ujin  
Dhe në ndërgjegje mbjellin.

\* \* \*

Lulet...

Lulet e para,

Kur pranverat derdhin buzëqeshjen e tyre mbi tokë

Ne i marrim të freskëta dhe i vëmë në lapidar...

Në heshtje, e zjarhtë ti na çfaqesh përsëri

Me flamurin e brigadës «Heronjtë e Vigut» në dorë

Dhe me një tufë rrezesh të pashuara në sy.

Por ja: Një krisëm e largët na këput mendimin,

Një natë mirditore thyhet bash në mes,

Një zë i tingullt na freskon kujtimin:

— «Mua mund të më vrisni, . . . por  
Malësia nuk vdes. . .».

Ti mbete e fortë ballë klithmës së kriminelëve,  
Por ata kishin pushkë, Mrikë, kishin pushkë,  
Grykët e tyre t'i drejtuan bash në zemër.  
Armiku e dinte se komunizmi aty ndriste  
Dhe desh ta vriste.

\* \* \*

Në Kurbnesh u bë mbledhja e asamblesë,  
Tri katunde u bashkuan në vrullin e ri. . .  
Cucat flakën tej shaminë e zezë,  
Katundet në flakë revolucioni  
Dogjën distanca e kufij,  
Horizonti u bë më i gjerë se dje,  
Zemrat më të gjera se horizonti u bënë.  
Sot njerëzit nisën një rrugë të re  
Ku seicili ka diçka për të thënë.  
Kjo grua tani sapo doli nga ara  
Me baltë e ka dorën që ngriti n'asamble:  
— Me leje, shokë, emërin Shkurtë Cara  
Ta vemë në ballë të kooperativës së re!

Veteranin e tradhëton një bulë lot.  
Një nënë ngre ballin dhe mendon pak.

Ky pionier dorën e së motrës shtrëngon fort  
Dhe buqeta duartrokitjesh ngrihen lart...  
Ato ushtojnë si simfoni në mal e shpat,  
Minat galerive ushtimën e pasojnë.  
Maqinat me bori përshëndesin që larg.  
Rreth lapidarit tënd, o Shkurtë  
Fatosat këndojnë.

\* \* \*

Tani është maj.  
Fushave të Myzeqesë lulet kundërmojnë,  
Vrulli rinor i rritet Myzeqesë.  
Një vullnetare mirditore dhe një gjirokastrite  
Dorë për dorë shetisin buzë trasesë,  
Me radhë njëra tjetrës i tregojnë...  
Pranë lapidarit të Shkurtë Vatës ulen,  
Maria flet për Marten dhe Prenën.  
Lilika për Persefonin dhe Bulen.

Ky tregim nisi në vite të ndryshme  
Dhe s'flet për dhëmbje e lot,  
Ai flet thjeshtë për heroizmin  
Që lart po e ngjitin  
Shqiponjat e reja sot.

O motra heroike,  
 Ju ishit të parat vullnetare  
 Që i dhatë djersën hekurudhës së parë.  
 Ju vështronit shinat mbi trase  
 Si dy duar  
 Të fuqishme, të hekurta  
 Që zgjaste për të rrokur socializmin  
 I dashuri atdhe.

Pranë shinave të reja  
 Ju mësuat shkronjat e para.  
 I morët me vete ato shkronja, ende të pasigurta  
 Për t'i bërë në Mirditë  
 Si shinat  
 Të forta,  
 Të drejta  
 Të sigurta  
 Që të mund të kalonin lirisht mbi 'to pastaj  
 Lokomotiva e dijes  
 Dhe vagonat e librave të reja.

Dhe morët atje mbi të gjitha  
 Gjënë më të sigurt,  
 Fjalën më të bukur të Shqipërisë:  
 Tëserën e kuqe të partisë.



\* \* \*

Por armiqtë të katrave ju vranë natën,  
Se natën në ndërgjegje ata kishin,  
Se vetë të zes dhe të  
Pabesë  
Si vetë nata ishin.

Mrikë,  
Shkurtë,  
Martë,  
Prenë!

Secila prej jush ka një emër,  
Por si t'ju ndaj, si t'ju thërres me poezinë?  
Të katra bashkë ju jeni një zemër  
Që rrahu përjetësisht për Partinë!

## PASQYRA E LËNËS

Faqe

Mendime buzë lumit Drin .....	3
Dje të lapidari .....	6
Tregimi i veteranit .....	8
Kirurgët e maleve .....	10
Gjirokastër .....	14
Kur zgjohen bjeshkët .....	16
Tinguj të vendit tim .....	17
Balladë për Shkurte Carën .....	20
Kur shkoj në telegrafë .....	22
Mbi urën e Fanit .....	23
Bisedë me vajzën .....	24
Për Migjenin .....	25
Duvaku i grisur .....	26
Dëshirë .....	27
Njeriu i bronxtë .....	28
Një dritë e fortë .....	29
Letër studentes .....	31
Pyetje poezisë .....	32
Nga ditari i vitit 1967 .....	34
Forcë nga malet .....	38
Kur lind dielli .....	40
Medalja e poetit .....	41
Për varret e huaj .....	42
Motive mirditore .....	43
Katër heroinave të Mirditës .....	50